

L I G J
Nr.8470, datë 7.4.1999

**PËR PRANIMIN NË SHQIPËRI TË NJË FORCE USHTARAKE TË NATO-S PËR
MBËSHTETJE TË OPERACIONEVE USHTARAKE NË RAJON**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 83 pika 1 dhe 84 pika 4 të Kushtetutës, me kërkesën e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pranohet në Shqipëri një forcë ushtarake e NATO-s dhe lejohet për kryerjen e operacioneve ushtarake për përballimin e problemeve humanitare, të gjendjes dhe sigurisë kombëtare, si dhe për mbështetje të operacioneve ushtarake në rajon.

Neni 2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.2345, datë 8.4.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**